



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Aritech" Sh.P.K. të datës 27.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Aritech" Sh.P.K. e datës 27.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Aritech" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Aritech" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit kanë të bëjnë me arsyet për eliminimin e tenderuesit si të papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit me rastin e administrimit të dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi dhe krahasimit të tyre me sqarimet shtesë të dërguara më vonë te autoriteti kontraktues është gjetur se specifikat e pajisjes në broshurë sikurse janë nënvizuar nga parashtruesi dallojnë me specifikat e pajisjes në broshurë të nënvizuara me rastin e sqarimeve shtesë. Më konkretisht, parashtruesi gjatë fazës së tenderimit ka dorëzuar broshurat për poz. 2 dhe 3 "Lenovo Legion T7 34IAZ7" dhe ka nënvizuar modelin e procesorit "Core i712700KF respektivisht Core i912900KF" ndërsa pas kërkesës për sqarime parashtruesi ka dërguar broshurat për modelin e PC për poz. 2 dhe 3 "Legion T7 34IRZ8" dhe ka nënvizuar modelet e procesorëve "Core i714700KF respektivisht Core i914900K" gjë që bie ndesh me LPP, pasi që OE nuk ka drejtë të ndryshoj produktet pas hapjes së ofertave dhe vlerimit të tyre. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor i parashtruesit është pretendim i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të parashtruesit të cilat i referohen ekskluzivisht tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, është gjetur se parashtruesi duke qenë tenderues i papërgjegjshëm në këtë rast nuk mund të dëshmoj asnjë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht nuk është fare palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP me termin palë e interesuar nënkuptohet "*personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*".

Në rastin konkret parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm sikurse është sqaruar edhe më sipër në këtë vendim. Prandaj nga cilindo epilog i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit, parashtruesi në asnjë formë nuk mund të dëshmoj ndonjë interes material. Prandaj parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij dhe rrjedhimisht pretendimet e tij referuar kundër tenderuesve të tjerë janë të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.01.2024

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Kontingjenti i Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.